REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 519/22
Datë/Datum. 24.10.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**PSH.nr 519/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP, në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, Vedat Potërqoi -Referuese, Agon Ramadani-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së operatorit ekonomik NPN "Euroing" shpk - Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit: "Ndërtimi i Objektit te sallës së Edukatës Fizike dhe ngrohtores SHFMU Avdyl Frashëri – Prizren", me numër te prokurimit 208-22-4207-5-2-1, iniciuar nga Ministria e Arsimit. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 24.10.2022, mori:

## V E N D I M

1.Aprovohet pajtimi i palëve për ankesën 519/22 të datës 07. 10. 2022 lidhur aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Objektit te sallës së Edukatës Fizike dhe ngrohtores SHFMU Avdyl Frashëri – Prizren", me numër te prokurimit 208-22-4207-5-2-1, iniciuar nga Ministria e Arsimit.

2.Obligohet AK- Ministria e Arsimit që aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Objektit te sallës së Edukatës Fizike dhe ngrohtores SHFMU Avdyl Frashëri – Prizren", me numër te prokurimit 208-22-4207-5-2-1, konform raportit të ekspertit shqyrtues me të cilin AK është pajtuar, ta kthejë në Rivlerësim.

3. Brenda kuadrit kohor prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHPP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në harmoni me paragrafët specifik të dispozitivit të këtij Vendimi;

4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, Panelin Shqyrtues ka të drejtë që të ndërmarr masa sikurse parashihen ato me nenin 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092;

5. Lejohet kthimi i mjeteve në emër dhe për llogari të Ankuesit, të cilat janë deponuar për sigurimin e ankesës me rastin e parashtrimit të sajë. Sipas nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHPP, Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, të bëjë kërkesë për kthimin e mjeteve sipas paragrafit paraprak të këtij Vendimi, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Me 07. 10. 2022, OE ankues NPN "Euroing" shpk - Rahovec, ka ushtruar ankesë me nr: 519/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Objektit te sallës së Edukatës Fizike dhe ngrohtores SHFMU Avdyl Frashëri – Prizren", me numër te prokurimit 208-22-4207-5-2-1 iniciuar nga Ministria e Arsimit. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK),

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 06.10.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim: a) Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar; b) Vendimi i atakuar i AK, të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

-Me 17 tetor 2022, OSHP ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës me ç'rast konstatohet:
-Me 18 tetor 2022, AK ka njoftuar OSHP se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues duke theksuar në vijim, cituar: *"pajtohemi me mendimin e ekspertit në ekspertizën nr 512/22 lënda kthehet në Rivlerësim*
- Me 17 tetor 2022, Operatori ekonomik ankues NPN "Euroing" shpk - Rahovec" ka njoftuar OSHP se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues;

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu natyrës së kësaj lëndë, qëllimit, historikut të sajë dhe pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues konstatoi në vijim se

a)Autoriteti Kontraktues – Ministria e Arsimit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie te kontratë, përkatësisht kundër arsyetimit te eliminimit të OE NPN "Euroing" shpk ,përmes letrës standarde të datës 23.09.2022.

b)Lidhur me arsyet e eliminit të OE-ankues, Eksperti në raportin e tij të datës 17.10.2022 sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenit 59 dhe 56 pargrafi 3 i LPP cituar: "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati...,* ***nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit***". nuk qendrojne arsyet e dhwna nga AK tek pikat e eliminimit meqenëse nuk kanë qene kërkesë apo kriter i kualifikimit apo i përcaktuar ne njoftim për kontrate dhe në dosje te tenderit. Gabimet teknike me dispozita ligjore janë te korrigjueshme dhe jo përjashtuese, po ashtu qeshja e noterizimit është e rregulluar me Ligjin për Noterinë, rrjedhimisht zhvlerësimi i përgatitjes profesionale "Inxhinier i Ndërtimtarisë", me arsyetim te tille bie ndesh me te gjitha rregullat ligjore dhe parimet e prokurimit publik.

Paneli Shqyrtues duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu natyrës së kësaj lëndë, qëllimit, historikut të sajë dhe pretendimeve ankimore, Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe deklarimeve të palëve të cilat shprehimisht janë pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit, Paneli Shqyrtues deklaron se procedura e shqyrtimit në ketë Lëndë përfundon në këtë fazë të procedurës, ndërkaq AK obligohet që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj sipas konstatimeve të ekspertit shqyrtues dhe brenda afatit 10/dhjetë ditor konform LPP, ta njoftoj Panelin Shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform nenit 117 të

Kryesuese e Panelit e Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani

**Këshillë Juridike:**
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- Ministria e Arsimit

1x1 OE ankues NPN "Euroing" shpk

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së